



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVAT
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "STUDIO PEMA"

Nr. 1510 Prot.

Tirane më, 18.10.2019

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Në Tirane sot më 18.10.2019

Unë Elvis Sulkuqi, Përmbarues Gjyqësor dhe Administrator i Shoqërisë Përmbarimore "STUDIO PEMA" sh.p.k, pasi studiova dosjen përmbarimore si dhe në zbatim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 138, datë 20.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA

Se në datën 24.7.2019 Kreditori UKT sh.a (Ujësjiellës Kanalizime Tiranë) ka paraqitur pranë Shoqërisë Përmbarimore "STUDIO PEMA" sh.p.k kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv nr. 590234-1/faturat tatimore të konsumit të ujit të pijshëm, për periudhën Qershor 2013-Tetor 2018 për të cilin është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr. 138, datë 20.2.2019, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë:

Kreditor : UKT sh.a (Ujësjiellës Kanalizime Tiranë)
Debitor : LNK shpk K02003004P
Me objekt : Pagim Detyrimi (Fatura të papaguara të konsumit të ujit të pijshëm)

Në Vendimin Nr. 138, datë 20.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur detyrimi i palës debitore të përmbushë detyrimin duke bërë pagesën e faturave të papaguara të konsumit të ujit të pijshëm për periudhën Qershor 2013-Tetor 2018 ne favor të kreditorit UKT sh.a.

Me vendimin e Përmbaruesit Gjyqësor Privat ekzekutimi i Titullit Ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVAT
SHOQËRIA PËRMBARIMORE “STUDIO PEMA”

Në këto kushte, për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit të sipërcituar, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të kryhet bllokimi i aksioneve të debitorit, me qëllim mostjetërsimin e tyre për tu shmangur nga detyrimi.

Sa më lart, si dhe mbështetur në nenet 527 të Kodit Procedurës Civile në nenin 31 gërma b dhe nenin 46 të Ligjit nr.26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”

URDHËROJMË

1. Vënien e masës së sekuestros konservative mbi aksionet e debitorit LNK shpk LNK shpk K02003004P me qëllim mostjetërsimin e tyre për tu shmangur nga detyrimi për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv nr. 590234-1/faturat tatimore të konsumit të ujit të pijshëm, ne zbatim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 138, datë 20.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile.
4. Ky urdhër mbahet në disa kopje dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE “STUDIO PEMA” sh.p.k

PËRMBARUES GJYQËSOR

ELVIS SULKUQI

